

TË RINJTË PROACTIVE PËR DREJTËSI SOCIALE

Ne kemi lindur për të qënë të lirë dhe të gjithë të barabartë në të Drejta!



Projekte Vullnetare Ndërkombëtare



ÇFARË ËSHTË DREJTËSIA SOCIALE?

Drejtësia sociale është drejtësi për sa i përket shpërndarjes së pasurisë, mundësive dhe privilegjeve brenda një shoqërie. Çdo shpërndarje e padrejtë e pasurisë, mundësive dhe privilegjeve brenda një shoqërie përkthehet në padrejtësi sociale.

ÇFARË ËSHTË GJITHËPËRFSHIRJA?

Gjithëpërfshirja i referohet sjelljeve dhe normave sociale që sigurojnë që njerëzit të ndjehen të mirëpritur.

ÇFARË ËSHTË AKTIVIZMI?

Aktivizmi është reagim ndaj padrejtësisë, trajtimit abusiv, dhunës, diskriminimit and përpjekja për ta korrigjuar atë. Është gadishmëria për të asistuar dhe demonstruar solidaritet me përpjekjet e të tjerëve, të luftuarit për të siguruar që ata trajtohen me respekt dhe dinjitet dhe të ndihmohet në lëvizjen drejtë një shoqërie humane, të drejtë dhe ku respektohen të drejtat e njeriut.

ÇFARË ËSHTË DISKRIMINIMI?

Diskriminimi është akti i trajtimit të një personi ose një grupi të njerëzish, veçanërisht në një mënyrë të keqe nga mënyra që duhet të trajtohen për shkak të ngjyrës së lëkurës, seksit, seksualitetit, religjionit, paaftësisë fizike ose paaftësive të tjera.

ÇFARË ËSHTË GJUHA E URREJTJES?

Gjuha e urrejtjes, mbulon të gjitha format e shprehjes e cila shpërndanë, incion, promovonë dhe justifikon urrejtjen racore, ksenofobine, anti semitizmin ose forma të tjera të urrejtjes bazuar në intolerance, duke përfshirë intolerance e shprehur nëpërmjet nacionalismit agresivë dhe etnocentrizmit, diskriminimit dhe armiqësis kundrejt minoriteteve edhe migranteve dhe njerëzit me origin imigrante.

“PROAKTIV PËR DREJTËSI SOCIALE”

Projekti “ProAktiv për drejtësi sociale” ka per qellim te zhvillojë aftësitë e të rinjve në promovimin e drejtësisë sociale dhe luftimit të çfarëdo forme diskriminimit dhe dhune pavarësisht gjinisë, orientimit seksual, aftësive apo të qënit pjesë e një grupi të marxhinalizuar, etj.

Projekti nëpërmjet aktiviteteve të tij, fuqizojë 20 të rinj përfaqësues të organizatave lokale, të rinj, gazetarë të rinj, vullnetarë dhe aktivist të moshës 18-30 vjeç nga e gjithë Shqipëria që të bëhen agjentë ndryshimi në komunitetin ku ata jetojnë, duke i dhënë zë të drejtave të njeriut që flasin për një shoqëri pranuese, tolerante, paparagjykime, gjithëpërfshirëse dhe padhunë ndaj vajzave/grave, personave LGBTQI apo personave me mundësi të pakta.

Në kuadër të projektit u realizuan edhe një sërë produktesh mediatike si artikuj, podcaste, emisione radio për të rritur ndërgjegjësimin mbi nevojën për drejtësi sociale përkundrejt grupeve me mundësi të pakta.



Projekte Udhëtohet: Shqipëri Online



European Youth Foundation
from Karolinska Institutet & Erasmus

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE